

Nr. Prot
(Lutemi referoni këtë numër në përgjigje)

Tiranë, më _____.____. 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIT**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O Adresa: Rruga
"Dervish Hima", Pallati Ambasador III, Kati 4, Ap.nr 27, shkalla 1, Njësia nr.02, Tiranë

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar me mjete elektronike - mallra.

Numri i Procedurës /referenca e Lotit: NR.REF - 89362-06-09-2026.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje komplet ajërftohsash për një gjenerator në HEC Vau i Dejës (1x8 copë ajërftohesa për gjenerator)”. Fondi Limit: 57,000,000 (Pesëdhjetë e shtatë milion) Lekë pa TVSH ose 598,865 (pesëqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) Euro pa TVSH. Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 09.06.2026 është 95.18 Lekë/Euro. Kohëzgjatja e kontratës: 5 (Pesë) muaj.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **Datë 10/06/2026.**

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: **Nr 39 datë 15/06/2026.**

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) Operatori ekonomik “SAHORA” sh.p.k, NIPT L91703022T, me vlerë të ofertuar 48,051,000 (Dyzet e tetë milionë e pesëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2) Operatori ekonomik “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O, me vlerë të ofertuar 52,500,000 (Pesëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3) Operatori ekonomik “Eidon-Grup” sh.p.k, NIPT L91323019S, me vlerë të ofertuar 54,000,000 (Pesëdhjetë e katër milion) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4) Operatori ekonomik “JUNIK” sh.p.k, NIPT J68007522L, me vlerë të ofertuar 55,728,000 (Pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

Operatorin ekonomik “SAHORA” sh.p.k, NIPT L91703022T, me vlerë të ofertuar 48,051,000 (Dyzet e tetë milionë e pesëdhjetë e një mijë) Lekë pa TVSH, pasi:

1- Nuk plotëson kriterin 2.3.3 të kapacitetit teknik kërkesë e kriterëve për kualifikim ku është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht për periudhën Mars 2026 - Maj 2026, jo më pak se 1 (një) inxhinierë, nga të cilët të paktën:

 1 (një) inxhinier mekanik;

Në lidhje me këtë kriter te shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” Pika B “Informacion mbi subjektete mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështet operatori ekonomik”

operatori ekonomik “SAHORA” sh.p.k, ka deklaruar se mbështetet në kapacitetin teknik të subjekteve të tjera, në kundërshtim me përcaktimet e vendosura në Dokumente e Tenderit, pika 2.16.

Referuar kërkesave për kualifikimin të vendosura në Dokumentet e Tenderit “Njoftimi i kontratës” pika 2.16 “Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera”, është vendosur se:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve **ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.**

Po

X

Jo

☐

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspekte kritike, që ndalohet mbështetja:

Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera, për asnjë nga kërkesat e përcaktuara në DT si kapaciteti ekonomik e financiare aftësinë teknike ose profesionale .AK duhet të sigurohet se furnizuesi duhet të disponojë të gjitha kapacitetet e kërkuara në këtë procedurë për të bërë të mundur zbatimin sa më të suksesshëm të kontratës, kjo referuar rëndësisë që ka ky objekt për Autoritetin Kontraktor.

2- Nuk plotëson kriterin 2.3.1 të kapacitetit teknik në Dokumentet e Tenderit, ku është kërkuar, se operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur si dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, kontratat ku objekti i tyre është “Blerje pjesë këmbimi për automjete” si dhe fatura tatimore të shitjes që lidhen me furnizimin e pjesëve të këmbimit për automjete, uniformave të punës, artikujve të pastrimit, pajisjeve për mirëmbajtjen e sistemeve hidrosanitare etj. Këto furnizime nuk mund të konsiderohen furnizime të ngjashme me objektin e kësaj procedure prokurimi, pasi nuk paraqesin ngjashmëri nga pikëpamja teknike, funksionale, teknologjike dhe sipas fushës së industrisë ku përdoren.

Operatori ekonomik ka paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), Kontratën me objekt: “Blerje elektropompa për nevojat e shoqërisë”. Nga verifikimi rezulton se ky operator nuk plotëson pikën 2.3.1, kapaciteti teknik, pasi vlera e kontratës është më e vogël se vlera e kërkuar për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

* * *

Të kualifikojë si të vlefshme ofertat e operatorëve ekonomik si më poshtë:

1- Operatorin ekonomik “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O, me vlerë të ofertuar 52,500,000 (Pesëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH.

2- Operatorin ekonomik “Eidon-Grup” sh.p.k, NIPT L91323019S, me vlerë të ofertuar 54,000,000 (Pesëdhjetë e katër milion) Lekë pa TVSH.

3- Operatorin ekonomik “JUNIK” sh.p.k, NIPT J68007522L, me vlerë të ofertuar 55,728,000 (Pesëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e njëzetë e tetë mijë) Lekë pa TVSH.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Operatorin Ekonomik “NOVAMAT” sh.p.k, NIPT K81615002O Adresa: Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador III, Kati 4, Ap.nr 27, shkalla 1, Njësia nr.02, Tiranë, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 52,500,000 (Pesëdhjetë e dy milion e pesëqind mijë) Lekë pa TVSH., është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR